## Titulli i lëndës: Kujdesi infermieror te të sëmurët internistikë

| **Informatat themelore për lëndën** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Mjekësisë -Infermieri |
| **Titulli i lëndës:** | Kujdesi infermieror te të sëmurët internistikë |
| **Niveli:** | Bachellor |
| **Statusi i lëndës:** | obligative |
| **Viti i studimeve:** | II |
| **Numri i orëve në javë:** | 3 + 3 + 6 |
| **Kreditë ECTS:** | 7 |
| **Koha / Vendi:** | Në lokalet e Degës Infermieri dhe Mami |
| **Mësimdhënësi:** | Prof.ass.dr. Aurora Bakalli, Ass. Qëndresa Zogaj |
| **Të dhënat kontaktuese:** | Në lokalet e Degës Infermieri |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | *Lënda strukturohet sipas shtyllave kryesore të lëndëve internistike, siç janë: kardiologja, pulmologjia, gastroenterologjia, endokrinologjia, nefrologjia, hematologjia, reumatologjia.*<br><br>*Studentëve do të ju përshkruhen konceptet bazike të sëmundjeve internistike, do të mësohet nomenklatura e sëmundjeve internistike, do të sqarohen konceptet bazike të diagnostikimit dhe trajtimit të sëmundjeve internistike.*<br><br>*Theks i veçantë do të vendoset mbi qasjen e infermierit ndaj të sëmurit internistik si dhe kujdesin infermieror që duhet të ofroj infermieri te të sëmurët internistik.* |
| **Qëllimet e lëndës:** | *Të kuptuarit e koncepteve themelore të sëmundjeve internistike*<br>*Zhvillimi i shkathtësive të komunikimit me të sëmurin internistik*<br>*Zhvillimi i shkathtësive për bashkëpunim dhe punë ekipore rreth menaxhimit të të sëmurit internistik.*<br>*Përvetësimin e metodës së qasjes, intervistimit, komunikimit, marrjes së të dhënave anamnestike të të sëmurit internistik.*<br>*Arritja e njohurive themelore për sëmundjet internistike, metodat bazë për diagnostikimin, përcjelljen klinike dhe mjekimin e këtyre sëmundjeve.* |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | *Me përfundimin e lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:*<br>• *Kuptojnë përmbajtjen e lëndës, objektin e studimit dhe rëndësinë e saj në aplikimin e profesionit.*<br>• *Zhvillojnë shkathtësitë në komunikim dhe marrjen e të dhënave nga i sëmuri internistik.* |

| | |
|---|---|
| | • *Zhvillojnë shkathtësitë bazike në ekzaminimin klinik të të semurit internistk.*<br>• *Zhvillojnë aftësi të avansuara të kujdesit infermieror për të sëmurët internistik.* |

**Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 3 | 15 | 45 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 3 | 15 | 45 |
| Punë praktike | 6 | 15 | 90 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 0.5 | 2 | 1 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 0.5 | 2 | 1 |
| Detyrë shtëpie | 1 | 2 | 2 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 0.5 | 15 | 7 |
| Përgatitja për provimin final | 1 | 3 | 3 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 0.5 | 1 | 0.5 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 0.5 | 1 | 0.5 |
| **Total** | | | **195** |

| | |
|---|---|
| **Metodat e mësimdhënies:** | Ligjëratat me anë të LCC projektorëve, diskutimit aktiv me studentët, simulimit, prezantimit të rasteve.<br>Puna praktike në laborator dhe klinikë. |
| **Metodat e vlerësimit:** | Pjesëmarrja aktive në klasë: 30%;<br>Detyrat individuale të kryera në shtëpi, testi i parë: 30%;<br>Provimi: 40%. |
| **Literatura primare:** | 1. *Grup Autorësh. Parimet e Mjekësisë së Përgjithshme. Tiranë, 2002*<br>2. *Ralston, Stuart H., et al., editors. Davidson's Principles and Practice of Medicine. 23rd ed., Elsevier Health Sciences, 2018.* |
| **Literatura shtesë:** | 1. *The Physician Assistant Student’s Guide to the Clinical Year: Internal Medicine. Knechtel, David ;Opacic, Deborah ;Knechtel, Maureen. Springer Publishing Company. 2019.* |

**Hartimi i planit mësimor**

| Java | Titulli i ligjëratës |
|---|---|
| ***Java 1:*** | *Anamneza, intervistimi i të sëmurit internistik; Metodat e ekzaminimit objektiv (fizik); Ekzaminimi i përgjithshëm; Ekzaminimi i kokës dhe qafës* |
| ***Java 2:*** | *Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit respirator; Metodat diagnostike të sistemit respirator; Sëmundjet pulmonare obstrktive kronike; Bronkiektazitë; Astma bronkiale; Insuficienca respiratore; ARDS.* |

| | |
|---|---|
| ***Java 3*:** | *Pneumonitë; Tuberkulozi; Sëmundjet e pleurës; Tumorët e mushkërive; Sarkoidoza; Ekinokoku i mushkerise; Peumokoniozat; Tromboembolia pulmonare.* |
| ***Java 4:*** | *Anamneza dhe ekzaminimi objektiv (fizik) i sistemit kardiovaskular; Metodat diagnostike të sistemit kardiovaskular. Qasja infermierore ndaj të sëmurit kardiologjik. Kardiomiopatite. Insuficienca kardiake* |
| ***Java 5:*** | *Ethet reumatike; Endokarditet. Perikarditet.*<br>*Hipertensioni arterial; Veset e fituara të zemrës;*<br>*Veset kongjenitale të zemrës* |
| ***Java 6*:** | *Sëmundjet iskemike të zemrës;*<br>*Vdekja e papritur; Reanimimi kardiopulmonar. Çrregullimet e ritmit. Sëmundjet e aortës.* |
| ***Java 7:*** | *Anamneza dhe ekzaminimi objektiv i sistemit digjestiv; Metodat diagnostike. Qasja infermierore ndaj të sëmurit gastroenterologjik. Sëmundjet e ezofagut; Sëmundjet e lukthit dhe duodenit; Sëmundjet e zorrëve* |
| ***Java 8:*** | *Sëmundjet e mëlçisë; Sëmundjet e fshikëzës dhe rrugëve biliare; Sëmundjet e pankreasit* |
| ***Java 9:*** | *Anamneza, ekzaminimi objektiv dhe qasja infermierore ndaj të sëmurëve hematologjik.*<br>*Anemitë.* |
| ***Java 10:*** | *Çrregullimet e leukociteve; Çrregullimet mieloproliferative; Leukemitë; Limfomat; Çrregullimet e tromborciteve dhe hemostazës; Koagulopatitë.* |
| ***Java 11*:** | *Sëmundjet e veshkëve dhe traktit urinar. Anamneza dhe ekzaminimi objektiv i sistemit urogjenital. Qasja infermierore ndaj të sëmurit nefrologjik. Glomerulonefritet; Pielonefritet; Sindroma nefrotike dhe nefritike.* |
| ***Java 12*:** | *Nefrolitiaza; Kolikat renale; Cistitet; Insuficienca renale akute dhe kronike.* |
| ***Java 13*:** | *Anamneza, ekzaminimi objektiv dhe qasja infermierore ndaj të sëmurit endokrinologjik. Diabeti Melit; Diabeti Insipid; Sëmundjet e gjëndrës tiroide.* |
| ***Java 14*:** | *Semundjet e gjendrave paratiroide dhe crregullimet e tjera te metabolizimit fosfo-kalcik; Semundjet e gjendres mbiveshkore; Çrregullimet e hormoneve seksuale. Semundjet e hipotalamusit dhe hipofizes dhe sindromat klinike qe lidhen me disfunksionin e tyre;* |
| ***Java 15*:** | *Sëmundjet reumatizmale; Anamneza, ekzaminimi objektiv dhe qasja infermierore ndaj të sëmurit reumatologjik. Artritet seropozitive dhe seronegative. Osteoartritet; LES.* |

## Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.*
*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*